

# PËRMBLEDHJA E REKOMANDIMEVE TË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE- 2017

*-MBLEDHJA NR. 9-*

## FUQIA PUNËTORE E KUALIFIKUAR, MUNDËSI PËR INVESTIME SEKTORI I SHËRBIMEVE TË NËNKONTRAKTUARA (BPO)

**\*\*\***

*Në këtë mbledhje u evidentuan problemet kryesore në lidhje me Potencialet për Investime dhe Sfidat e Tregut të Punës në Sektorin e Shërbimeve të Nënkontraktuar (BPO). Në Mbledhje u paraqit një prezantim i ekspertëve të kompanisë AVASANT, kontraktuar në kuadrin e një projekti të financuar nga Qeveria Zvicerane si dhe gjetjet e një Pyetësores të kryer nga Sekretariati me 17 kompani BPO, me një numër prej 10.000 punonjësish. Vërebet një rritje e kërkesave për shërbime nga Shqipëria drejt vendeve të BE-së dhe ekzistenca e një potenciali të fuqishëm për investime në segmente të caktuara në sektor, ku kërkohet cilësi e lartë e aftësive në punë. KI miratoi në total 13 rekomandime të paraqitura nga Sekretariati në bashkëpunim me aktorët e përfshirë.*

*Për t'u përmbushur brenda një afati të shkurtër kohor*

### *Rekomandim 1*

Forcimi i shoqatës AOA (Albanian Outsourcing Association) dhe rritja e rolit të saj dhe/ose shoqatave të tjera të cilat kanë interes në sektor për të luftuar informalitetin në bashkëpunim me institucionet shtetërore (Tatime, Inspektoriat i Punës etj.) Shteti (DPT, Inspektoriatet) të zbatojë funksionet monitoruese për të mundësuar një konkurrencë të ndershme në këtë sektor (iniciuar fushata pilot).

### *Rekomandim 2*

Të konsiderohet nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë mundësia që për personat e punësuar rishtaz në sektorët labor intense dhe në zhvillim si BPO (kompani që ushtrojnë aktivitetet për shërbimet outsourcing & call centers) kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për muajin e parë (periudha e trajnimit) të mbulohen nga Shteti dhe jo nga sipërmarrësi. *(Sipas Rekomandimit Nr. 2.3 të Mbledhjes së KI datë 27.04.2016).*

*Për t'u përmbushur brenda një afati të mesëm kohor*

### *Rekomandim 3*

Të konsiderohet sa më parë integrimi i njohurive bazë në nivele të caktuara të arsimimit, me fokus: aftësitë analitike (problem solving-zgjidhjen e problemeve), gjuhët e huaja, aftësi në Microsoft, Aftësi në Komunikim. Praktikrat të standardizohen dhe të bëhen pjesë e kurrikulës - projekt model biznes – fakultet – praktika mesimore. Akreditimi i Universiteteve të konsiderojë monitorimin e marrëdhënieve shtet-biznes për zbatimin efektiv të praktikave si pjesë e kurrikulave.

#### *Rekomandim 4*

Të ngrihet një grup pune (INSTAT, AIDA, Shoqata BPO, MAS, etj.) që të mundësojë skanimin e sektorit, saktësimin e të dhënave, modelin e bashkëpunimit në kuadër të arsimit dhe formimit profesional-VET (Vocational Educational Trainings) dhe biznesin.

#### *Rekomandim 5*

Rritje të partneritetit të universiteteve me sektorin privat dhe Zyrat e Punës nëpërmjet forcimit të rolit të Zyrave të Karrierës në internshipe, praktika dhe punësim të studentëve, zhvillim i hershëm i këshillimit të karrierës që në Universitete.

#### *Rekomandim 6*

Përshtatja e kurrikulave universitare për industri të caktuara me anë të zbatimit të projekteve dhe lëndëve mësimore nga ambjenti i biznesit vendas. Fleksibilitet në ofrimin e dijes nga Universitetet publike nëpërmjet programeve afatshkurtra inovative në partneritet me biznesin: Akademi Biznesi (programe intensive 1-3 ditë në një fushë të caktuar si psh: Konsulencë në Menaxhim dhe Operacione, Taksa, Hartime planesh biznesi, Studime fizibiliteti, etj.) Çertifikatat e marra pas përfundimit me sukses të jenë të akredituara nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë si një vlerë e shtuar për akses në tregun e punës.

#### *Rekomandim 7*

Nisma për krijimin e “*pool of talents*” në sektorin IT të cilët identifikohen përmes konkurseve apo aktiviteteve të tjera që mund të organizohen në bashkëpunim me shkollat profesionale në IT dhe universitetet apo shkollat e mesme.

#### *Rekomandim 8*

Mbështetje e iniciativave të biznesit për krijimin e qendrave të kualifikimit të vazhdueshëm në teknologji dhe novacion (Digital Academy), si edhe “software house” për krijimin e një pool IT ekspertesh të çertifikuar.

#### *Rekomandim 9*

Të konsiderohet, incentivimi nëpërmjet kontratave që kompanitë IT marrin nga shteti si p.sh përfshirja në termat e referencës e trajnimeve në IT ose marrja e studenteve apo sapodiplomuarve për internship në profesione relevante me tenderin e fituar për një periudhë kohe të caktuar.

*Për t'u përmbushur në vazhdimësi dhe afatgjatë*

#### *Rekomandim 10*

Promovim i praktikave të mira të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të disa kompanive të mëdha në kompani të tjera nëpërmjet shoqatave të biznesit, forumet e Burimeve Njerëzore të organizuara nga institucionet akademike dhe biznese dhe Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë duke nisur nga:

- a) Analizimi i kërkesës për kompetenca sipas sektorit të BPO;
- b) Përcaktimi i qartë i “Value Proposition” që ju ofrohet forcave të punës nga BPO: përveç pagesës, cikli i zhvillimit të aftësive profesionale në këta punëdhënës, *career path* në afatmesëm dhe afatgjatë, trajnimet që ofrohen dhe sa kompetitive do të jenë me kompetencat e fituara nga kjo punë;
- c) Hartimi i politikave për motivimin dhe ruajtjen e stafit cilësor në afatgjatë;

#### *Rekomandim 11*

Krijimi i një WEB Platforme, AIDA, Komuniteti i Biznesit, Universitetet, etj. për të mbështetur Biznesin në kërkesat për personel, tema diplomash/projekt propozime për t’u implementuar nga ana e biznesit.

#### *Rekomandim 12*

Ngritja e kapaciteteve dhe monitorimi i Zyrave të Punës për t’iu përgjigjur me programet e punësimit dhe kualifikimit nevojave të bizneseve BPO.

#### *Rekomandim 13*

Diskutim me aktorë mbi ngritjen e një Akademie BPO për rikualifikim të fuqisë punëtore, nga trajnerë të licensuar, nën mbështetjen e pushtetit qendror apo vendor në modelin e partneritet publik privat (Protik) ose model TEDA.

\*\*\*

*-MBLEDHJA NR. 10-*

**MBI LEHTËSIMIN E PROCEDURAVE DOGANORE**

*Objekti i analizës në këtë Mbledhje ishte lehtësimi i procedurave doganore, me synim rritjen e konkurrueshmërisë dhe stimulimin e eksporteve shqiptare. KI miratoi në total 17 rekomandime të ndara në 6 grupe kryesore si më poshtë:*

**\*\*\***

**a) KUADRI LIGJOR NË FUSHËN DOGANORE**

*Për t'u përmbushur brenda një afati të shkurtër kohor*

*Rekomandim 1*

Përgatitja në kohë e legjislacionit sekondar dhe konsultimi me biznesin, si një praktikë e mirë për nxitjen e partneritetit.

1. Përgatitja dhe miratimi në kohë e legjislacionit sekondar për të siguruar zbatimin me rigorozitet të Kodit të Ri Doganor.
2. Faza kalimtare deri në zëvendësimin e kuadrit ligjor doganor dhe hyrjen në fuqi në datën 1 Qershor 2017 të Kodit Doganor të ri, duhet të shfrytëzohet nga DPD në takime dhe tryeza të rrumbullakëta me biznese, ekspertë, agjenci doganore, shoqata biznesi etj., për të marrë mendime, opinione, për të bërë të njohur dhe për të konsultuar me të gjitha palët e interesuara, përgatitjen e këtyre akteve nënligjore ku me rëndësi të posaçme është VKM "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor".

**b) TË DHËNAT E DISPONUESHME (ÇMIMET E REFERENCËS)**

*Për t'u përmbushur brenda një afati të shkurtër kohor*

*Rekomandim 2*

Dokumentimi i qartë dhe gjurmimi në sistemin e brendshëm të DPD të mënyrave të llogaritjes së vlerës doganore. Për të qartësuar procedurat, si për administratën doganore dhe për biznesin sugjerohen:

1. Një manual më i qartë me hapat që duhet të ndiqen për rivlerësimet doganore (rishikim i Udhëzimit Nr. 25 Datë 30.11.2007) duke reduktuar faktorët që duhet të analizojë/ndjekë doganieri në njohjen e vlerës së transaksionit.
2. Akti i inspektimit të përgatitur duhet të ketë të qartë të gjitha hapat që ndiqen dhe të jetë i formatuar në sistem për të dokumentuar mënyrat alternative të vlerësimit.

3. Autoritetet doganore të vënë në dispozicion të operatorit ekonomik (të printuar apo elektronikisht) aktin e inspektimit i cili mban shenime për vlerën doganore dhe rezultatet e kontrollit fizik nëse ka.

#### *Rekomandim 3*

Përditësimi në Website i listës së të dhënave të disponueshme. Për të rritur transparencën dhe besimin me biznesin është e nevojshme që lista të jetë e përditësuar me historikun e azhurnimeve të saj. Të evidentohet dhe procesi i konsultimit me bizneset apo burime të tjera dhe data e përditësimit të listës.

#### *Rekomandim 4*

Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të konsiderojnë me një akt/urdhër heqjen e çmimeve të referencës për shpenzimet e transportit me kontenier.

#### *Rekomandim 5*

Interpretimi me anë të një Vendimi të Këshillit të Ministrave për procedurat që duhet të ndiqen për zbatimin e duhur të rekomandimeve të lëna nga raportet e KLSH. Organet e administratës publike përfshirë dhe administratën doganore duhet të shqyrtojnë me grupe pune detyrat dhe rekomandimet e lëna nga KLSH, duke shmangur zbatimin *a priori dhe automatikisht* të tyre, sidomos në rastin kur nga zbatimi i tyre arbitrar dhe me efekt prapaveprues, çënohet siguria juridike dhe të drejta të ligjshme të bizneseve.

*Për t'u përmbushur në vazhdimësi dhe afatgjatë*

#### *Rekomandim 6*

Publikimi i të dhënave mbi zbatimin e çmimeve të referencës nga DPD dhe rastet më të ndeshura të lidhura me origjinën e mallrave, natyrën e mallrave, etj. DPD të publikojë periodikisht ose si pjesë e raportit vjetor të punës të dhëna mbi zbatimin e vlerësimeve alternative të vlerës doganore sidomos çmimeve të referencës, mënyrës së adresimit të rasteve më tipike, etj.

#### **c) *KLASIFIKIMI TARIFOR I MALLRAVE***

*Për t'u përmbushur brenda një afati të shkurtër kohor*

#### *Rekomandim 7*

Degët doganore t'i kthejnë biznesit përgjigje me shkrim mbi konkluzionet e laboratorit të doganës kur merret mostër për analizë duke argumentuar arsyet e ndryshimit të klasifikimit tarifor të mallit.

#### *Rekomandim 8*

Të promovohet në faqen e internetit të DPD mundësia për aplikim nga bizneset për Informacion Tarifor i Detyrueshëm si dhe të publikohen të gjitha vendimet e marra mbi këto kërkesa. Njëkohësisht të rritet bashkëpunimi me Shoqatat e Biznesit dhe roli i tyre për të nxitur përdorimin e këtij mekanizmi.

#### **d) EFIÇENCA E KONTROLLEVE FIZIKE**

*Për t'u përmbushur në vazhdimësi dhe afatgjatë*

#### *Rekomandim 9*

Publikimi i të dhënave mbi llojet e kontrolleve (pa përfshirë të dhënat mbi indikatorët e riskut apo gjetjet nga kontrollet të cilat janë për përdorim të brendshëm të DPD) si pjesë e raportit vjetor të performancës të administratës doganore për të rritur transparencën dhe llogaridhënien ndaj taksapaguesve.

#### *Rekomandim 10*

Të shikohet mundësia e reduktimit të kontrolleve fizike nëpërmjet përditësimit të vazhdueshëm të indikatorëve të riskut, investimit në sisteme të Inteligjencës dhe IT dhe koordinimit të kontrolleve me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (zbatimi i kanalit blu). Investimi i vazhdueshëm në teknologjinë e informacionit për të mundësuar përditësimin e indikatorëve dhe shkëmbimin e informacionit midis agjencive ligjzbatuese do të rritë efikasitetin e sistemit të menaxhimit të riskut. Këto masa do të adresojnë edhe kërkesat e Kodit Doganor të ri lidhur me *analizën paraprake të riskut* mbi bazën e depozitimit paraprak të informacionit nga operatorët ekonomikë.

#### *Rekomandim 11*

Të ndërtohen ambiente të përshtatshme për kontroll fizik pranë degëve doganore. Në pamundësi për realizimin e këtij rekomandimi në afat të shkurtër, të rritet numri i kontrolleve fizike që kryhen në ambjentet e operatorëve ekonomikë ku gjatë gjatë shkarkimit të mallit të ketë dhe përfaqësues të autoritetit doganor. Arritja e objektivave të mësipërm kërkon mbështetjen nga Qeveria me buxhet dhe burime njerëzore në dispozicion të DPD.

#### **e) INSTITUCIONALIZIMI I INFORMIMIT DHE KONSULTIMI ME BIZNESET**

*Për t'u përmbushur brenda një afati të shkurtër kohor*

#### *Rekomandim 12*

Të bëhet rikonfigurimi i faqes së internetit, mundësisht të testohet me bizneset për ta bërë më informative dhe të përdorshme nga bizneset. Të pasurohet me informacion dhe udhëzime sqaruese në shqip dhe anglisht. Të shikohet mundësia e regjistrimit të bizneseve në faqe për të

marrë njoftimet në kohë reale. Sugjerohet që informacioni të jetë më i përditësuar dhe plotësuar me sqarime dhe udhëzime për bizneset si dhe mundësisht dhe në gjuhën angleze.

#### *Rekomandim 13*

Të konsiderohet publikimi i një plani konsultimi me përfaqësuesit e komunitetit të biznesit ndoshta dhe sektorial. Konsultimi me grupet e interesit i dispozitave zbatuese të kodit të ri doganor që janë në proces hartimi nga DPD dhe Ministria e Financave. Sekretariati mund të shërbejë si një mekanizëm për të ofruar mundësi konsultimi me grupe të caktuara interesi.

*Për t'u përmbushur brenda një afati të mesëm kohor*

#### *Rekomandim 14*

Mbështetje financiare për DPD për ngritjen e një strukture të dedikuar për të ofruar asistencë dhe komunikim të vazhdueshëm me operatorët ekonomikë dhe shoqatat e biznesit.

### **f) TË TJERA**

*Për t'u përmbushur brenda një afati të shkurtër kohor*

#### *Rekomandim 15*

Aplikimet për autorizime të bëhen online

1. Aplikimet për autorizime apo vërtetime mund të depozitohen në rrugë elektronike dhe të mundësohet njohja e dokumentave të skanuara.
2. Bizneseve të mos iu kërkohen vërtetim mbi situatën financiare në doganë, kur administrata doganore mund ta verifikojë vetë në sistem statusin e operatorit ekonomik.

#### *Rekomandim 16*

Të konsiderohet publikimi i një plani konsultimi me përfaqësuesit e komunitetit të biznesit ndoshta dhe sektorial. Konsultimi me grupet e interesit i dispozitave zbatuese të kodit të ri doganor që janë në proces hartimi nga DPD dhe Ministria e Financave është i domosdoshëm. Numri i bizneseve të konsultuara duhet të jetë indikator i performancës për DPD dhe pjesë e raportimit vjetor.

*Për t'u përmbushur brenda një afati të mesëm kohor*

#### *Rekomandim 17*

Të rritet shkëmbimi online i informacionit ose aksesit për një numër të caktuar të dhënash për të reduktuar barrën për biznesin dhe rritur shpejtësinë e procesimit të shkëmbimeve tregtare, si psh. rasti i vërtetimit të detyrimeve fiskale.

\*\*\*

*-MBLEDHJA NR. 11-*

**VROJTIM MBI ADMINISTRIMIN TATIMOR & INFORMALITETIN**

*Në fokus të mbledhjes ishte prezantimi dhe diskutimi i gjetjeve të vrojtimit me 146 biznese, kryer nga Sekretariati i KI në bashkëpunim me Universitetin Epoka gjatë periudhës Korrik – Shtator 2017. Vrojtimi kishte për qëllim evidentimin e ecurisë së shqetësimeve kryesore të biznesit, krahasuar me gjetjet e Sekretariatit gjatë 2015-2016, kryesisht lidhur me Inspektimin Tatimor dhe Marrëdhëniet me Administratën Tatimore, Informalitetin, dhe Rimbursimin e TVSH-së. Në mbledhje nuk u miratuan rekomandime konkrete, por u bë një raport mbi statusin e rekomandimeve përkatëse të bëra për çështjet e mësipërme në mbledhjet e mëparshme të KI.*